



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 211, datë 20.4.2018

PËR

KRIJIMIN E FONDIT TË INOVACIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të ligjit nr.8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar, të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr.10303, datë 15.7.2010, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)”, dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Fondit të Inovacionit, me vlerë të përgjithshme prej 45 000 000 (dyzet e pesë milionë) lekësh, për një kohëzgjatje zbatimi prej 3 (tre) vjetësh, për periudhën 2018-2020. Vlera e fondit për secilin vit do të jetë 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë.
2. Fondi i Inovacionit synon fuqizimin e ndërmarrjeve vendase, për përmirësimin e teknologjisë dhe nxitjen e inovacionit.
3. Fondi i Inovacionit, përveç fondeve nga buxheti i shtetit, sipas parashikimit të pikës 1, mund të ketë si burim financimi edhe donatorë të ndryshëm apo institucione financiare ndërkombëtare. Përfitimi nga fondet e akorduara nga donatorët apo institucionet financiare ndërkombëtare për këto ndërmarrje nuk përbën pengesë për përfitim edhe nga ky fond.

4. Fondi mbulon 50% të kostove të pranueshme dhe të miratuara nga komisioni vlerësues, në varësi të projektit konkurrues, dhe financim deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë.
Për ndërmarrjet që do të aplikojnë për “blerje pajisjesh teknologjike” financimi do të jetë jo më shumë se 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë.
5. Në kostot e pranueshme, që mund të bashkëfinancohen, përfshihen kostot për:
 - a) auditim të kapacitetit inovativ dhe teknologjik, që synon t’u mundësojë ndërmarrjeve aplikante vlerësimin për nivelin ekzistues të teknologjisë dhe mundësitë për rinovimin e tyre të inovacionit dhe/ose pozicionimit teknologjik, sipas një strukture konkurruese zhvillimi;
 - b) ndërkombëtarizimin e teknologjisë, e cila synon t’u mundësojë ndërmarrjeve aplikante të identifikojnë dhe të inspektojnë teknologjinë që kërkojnë të përshtatin;
 - c) pjesëmarrje në panairë inovacioni, teknologjie dhe promovimi, në lidhje me inovacione të ndërmarrjes;
 - ç) blerje pajisjesh teknologjike, që ndikojnë në rritjen e kapaciteteve inovative dhe teknologjike të ndërmarrjes.
 - d) licenca ose patenta (*software* ose *hardware*).
6. Nga Fondi i Inovacionit përfitojnë ndërmarrjet që plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - a) Janë biznese të klasifikuara si mikro, të vogla apo të mesme, sipas nenit 4, të ligjit nr.8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar.
 - b) Kanë selinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
 - c) Prodhojnë në Shqipëri produkte dhe/apo ofrojnë shërbime inovative, të cilat tregtohen brenda dhe/apo jashtë vendit.
7. Pagesa e fondit bëhet 50% në fillim të projektit dhe 50% në përfundim të tij, kundrejt faturës së shpenzimeve të kryera.
8. Procedurat e aplikimit dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Fondit të Inovacionit, e cila miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë.
9. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për menaxhimin e Fondit të Inovacionit.
10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përfshihen në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë, e cila krijon një zë të veçantë

për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s.

11. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
ARBEN AHMETAJ**